

UDHËZUES

PËR PROCEDURËN E DISBURSIMIT TË FONDEVE TË GRANTIT

1. Hyrje

Ky udhëzues mbështetet në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” dhe Rregulloren “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për t’u paraqitur nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve që aplikojnë për masa mbështetëse”. Udhëzuesi ka për synim të ndihmojë subjektet përfituese në përgatitjen sa më të saktë të dokumentacionit të nevojshëm për justifikimin e shpenzimeve të kryera me fondet e grantit të përfituar.

2. Disbursimi i fondeve

2.1. Disbursimi i fondeve të grantit për projektet e shpallura fituese, për “lehtësuesit” dhe “startup-et”, bëhet deri në maksimumi 3 këste.

- a) Për fituesit e kategorisë lehtësues që janë “Institucione arsimore” ose “Bashki”, disbursimi i fondit të grantit bëhet me parafinancim, sipas fazave të rëna dakord në kontratë. Pas përfundimit të projektit, kjo kategori duhet të dorëzojë dokumentet e cituara në pikën 3 të këtij udhëzuesi.
- b) Për subjektet e tjera përfituese që nuk përshihen në pikën “2.1.a” mësipër, disbursimi i fondeve të grantit bëhet me këste kundrejt dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar në pikën 3 të këtij udhëzuesi.

2.2. Disbursimi i fondit bëhet me transfertë bankare në llogarinë e fituesit, brenda 15-ditëve pune nga momenti i verifikimit dhe miratimit të dokumentacionit të kërkuar.

3. Dokumentet e nevojshme

3.1. Subjektet përfituese duhet të dorëzojnë një raport financiar për secilin prej kësteve përkatëse dhe një raport përmbledhës përfundimtar. Dokumentacioni paraqitet në origjinal ose në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin.

3.2. Raporti financiar për këstin përkatës për justifikimin e shpenzimeve duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a) Të gjitha faturat e blerjeve/shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës përkatëse të raportimit. Faturat duhet të jenë të fiskalizuara konform legjislacionit në fuqi. Zërat e shpenzimeve në faturat e blerjeve/shpenzimeve duhet të jenë të njëjta me zërat e

buxhetit të miratuar që i është bashkëlidhur kontratës së nënshkruar midis palëve. Objekti i aktivitetit të shitësit në ekstraktin e QKB, duhet të jetë në përputhje me mallrat apo shërbimet që ai i ka shitur subjektit fitues të grantit.

- b) Transfertat bankare, të cilat konfirmojnë kryerjen e pagesave. Transfertat bankare duhet të jenë të printuara nga sistemi i bankës dhe të jenë të firmosura dhe vulosura nga banka përkatëse.
 - c) Një raport financiar që përmbledh të gjitha faturat e dorëzuara për periudhën përkatëse të raportimit, sipas formatit të paraqitur në *Shtojcën A* bashkëlidhur këtij udhëzuesi.
- 3.3. Raporti përmbledhës në përfundim të projektit përgatitet sipas formatit të paraqitur në *Shtojcën B*, bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Raporti përmbledhës përfundimtar dorëzohet para disbursimit të kështit të fazës së fundit dhe duhet të përmbajë: dëshminë e subjektit mbi hapat dhe aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e projektit; përshkrimin e shpenzimeve të realizuara; impaktin e pritshëm pas zbatimit të projektit; fotografi dëshmuese të shpenzimeve të kryera dhe aktivitetëve të realizuara sipas planit të aplikimit të miratuar.

4. Verifikimi i dokumentacionit

- 4.1. Pas marrjes së dokumentacionit nga subjekti, skuadra e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, bën kontrollin dhe verifikimin e tij. Kur dokumentacioni i dorëzuar është i plotë, ai bën miratimin e tij dhe autorizon kryerjen e disbursimit të kështit përkatës.
- 4.2. Kur dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti është i paqartë, i paplotë dhe nuk plotëson kërkesat e rregullores dhe këtij udhëzuesi, njoftohet subjekti përkatës:
- a) Në rastet kur dokumentacioni justifikues financiar është i paqartë apo i paplotë, subjekti do të njoftohet për të kryer shpjegimet, dorëzimin e dokumentacionit shtesë apo plotësimet përkatëse;
 - b) Në rastet kur të dhënat e paraqitura në raportin përmbledhës nuk plotësojnë kërkesat përkatëse, raporti do t'i kthehet subjektit, i shoqëruar me komentet përkatëse dhe shpjegimet në lidhje me të dhënat ose detajimet shtesë që kërkohen.
- 4.3. Në të dy rastet e mësipërme, subjekti duhet të plotësojë dhe dorëzojë sqarimet, apo dokumentacionin shtesë, plotësimet përkatëse brenda 5 ditëve pune nga marrja e njoftimit.

Shtojca A:

RAPORTI FINANCIAR

Titulli i projektit:	
Emri i subjektit:	
Kategoria: nëse “Lehtësues”:	☐ Akademi; ☐ Bashki; ☐ Inkubator/Përshpejtues; ☐ Organizues eventesh; ☐ Arsim i mesëm dhe profesional.
Kategoria; nëse “Startup”:	☐ Fazë fillestare; ☐ 0-1 vit; ☐ 1-5 vite.

Raporti i shpenzimeve

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë	Totali (pa TVSH)	Totali (me TVSH)	Burimi i financimit	
							Nga Granti (pa TVSH)	Nga Subjekti (pa tVSH)
1	Shpenzimi nr.1: (Zërat e faturave duhet të jenë të njëjta me zërat e buxhetit të miratuar që i është bashkëlidhur kontratës së nënshkruar midis palëve)							
2	Shpenzimi nr. 2							
3	Shpenzimi nr. 3							
.								
Total								

Emri, Mbiemri dhe Firma e përfaqësuesit të subjektit: _____

Shtojca B:

RAPORTI PËRMBLEDHËS PËRFUNDIMTAR

Titulli i projektit:	
Emri i subjektit:	
Kategoria:	☐ Lehtësues; ☐ Startup
<i>Nëse "lehtësues"</i>	☐ Akademi; ☐ Bashki; ☐ Inkubator/Përsheptues; ☐ Organizues eventesh; ☐ Arsimit mesëm dhe profesional.
<i>Nëse "Startup"</i>	☐ Fazë fillestare; ☐ 0-1 vit; ☐ 1-5 vite.
Totali i shpenzimeve të projektit:	
Shuma e financuar nga Grant-i:	
Shuma e vetëfinancimit:	

1. Përmbledhje e aktiviteteve

Nr.	Aktivitete të parashikuara sipas kontratës mes palëve	Aktivitete të ndërmarra/realizuara në fakt për zbatimin e projektit
1		
2		
.		

2. Përshkrim i shpenzimeve të realizuara

Nr.	Lloji i shpenzimit	Përshkrimi i shpenzimit
1	Shpenzimi nr.1: (Titulli i shpenzimit dhe zërat nga të cilat përbëhet)	Përshkruani me fjalë llojin e shpenzimit në qelizën "Lloji i shpenzimit sipas zërave përkatës" dhe detajoni kostot për secilin zë (p.sh: shpenzimi nr.1 Blerje pajisje 3D, njësia: copë, sasia: 1, çmimi: 300,000, Totali pa TVSH: 240,000, Totali me TVSH: 300,000)
.		
.		
	Total pa TVSH	Vendosni totalin e të gjithë zërave të shpenzimeve të mësipërme pa TVSH (p.sh: 1,280,000)
	Granti i përfituar mbi totalin pa TVSH	Vendosni vlerën totale të grantit të përfituar (p.sh: nëse jeni aplikant startup, vlera e grantit është: Totali i mësipërm pa TVSH * 80% = 1,280,000*80% = 1,024,000)
	Kontributi i vetë aplikantit mbi totalin pa TVSH	Vendosni vlerën totale të kontributit që keni dhënë, sipas kontratës. (p.sh: nëse jeni aplikant startup, vlera totale e vetë kontributit është: Totali i mësipërm pa TVSH*20%. Ose Totali i mësipërm pa TVSH - grantin e kërkuar. P.sh: 1,280,000 * 20% = 256,000 ose 1,280,000 - 1,024,000 = 256,000)

3. Rezultatet e arritura dhe impakti i pritshëm pas zbatimit të projektit

Nr.	Rezultatet e arritura nga zbatimi i projektit	Impakti i pritshëm pas zbatimit të projektit
1		
2		
.		
.		

Emri, Mbiemri dhe Firma e përfaqësuesit të subjektit: _____

4. Aneks

Raportit përshkrues duhet t'i bashkëlidhni fotografi dëshmuuese të shpenzimeve të kryera, aktiviteteve të realizuara sipas planit të aplikimit të miratuar.